



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.1770/5 prot.

Datë 22.10.2021

**V E N D I M**

**Nr. 799/2021**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.10.2021 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Tibo Communication” ShPK në procedurën e prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr.REF-01153-07-16-2021 me objekt: “Shërbimi i internetit për një periudhë 3 vjeçare”, me fond limit 95,723,816 leke pa TVSh, zhvilluar me datë 23-08-2021 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group Sh.A.

**Ankimues:** “Albtelecom” Sh.A  
Rruga “Muhedin Llagami”, Kompleksi Square 21  
Tiranë-Shqipëri.

**Autoriteti Kontraktor:** OSHEE Group Sh. A  
Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa Nr. 88, H.1, Njësia  
Administrative Nr.7, 1023, Tiranë

**Subjekti i Interesuar:** Operatori ekonomik “Tibo Communication” SHPK  
Rruga e Kavajes, Pallati 132, Shk.3, Kati 1 , Tirane,  
Tirana

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**V ë r e n:****I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II***Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 18.07.2021 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr.REF-01153-07-16-2021 me objekt: “Shërbimi i internetit për një periudhë 3 vjeçare”, me fond limit 95,723,816 leke pa TVSh,

zhvilluar me datë 23-08-2021 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group Sh.A.

II.2. Në datën 14.09.2021, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 14.09.2021 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

- Nisatel	64,120,000	I skualifikuar
- Tibo Communication	69,656,400	I kualifikuar
- Albanian Telecommunications	71,887,250	I skualifikuar
- Union&Digi Com		
- Albtelecom	89,980,416	I kualifikuar
- Vodafone Albania	94,700,000	I kualifikuar
- A.S.T	259,426,800	I skualifikuar

II.4. Në datën 15.09.2021 autoriteti kontraktor ka kryer Publikimin e Njoftim Fituesit në sistemin e prokurimeve elektronike.

II.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton se në datën 22.09.2021 operatori ekonomik “ALBtelecom” SHA ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me pretendimet si më poshtë:

- *Në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik Tibo Communication ShPK AK dhe KVO ka gabuar në kualifikimin e operatorit ekonomik Tibo Communication ShPK pasi ky i fundit nuk përmbush kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT konkretisht: Në kriteret e veçanta të kualifikimit pika 2.2 kapaciteti ekonomik dhe financiar kërkohet: . Vlera e xhiros për të paktën një nga vitet (2018,2019,2020) duhet të jetë jo më e vogël se 100% e vlerës së fondit limit që prokurohet. - Vertetim nga Administrata Tatimore për xhiron e realizuar gjatë tre-viteve të fundit (2018,2019,2020) . Operatori ekonomik Tibo Communication ShPK nuk e plotëson kriterin e mësipërm referuar vlerave të xhirove vjetore të këtij operatori ekonomik sipas të dhënave që janë të aksesueshme për të gjithë në QKB. Kërkojmë të verifikohet në mënyrë të detajuar dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik Tibo Communication ShPK në lidhje me kriterin sa më sipër si dhe skualifikimin e tij nga kjo procedurë.*
- *Në kriteret e veçanta të kualifikimit pika 9 kërkohet: Ofruesi i shërbimit duhet të ofrojë dark fiber për lidhjen e Zyrave Qendrore me Disaster Recovery Site (të paraqitet deklaratë angazhimi).*

*Deklarata e angazhimit për përmbushjen e kriterit të mësipërm nga OE Tibo Communication ShPK është e pamundur për tu realizuar për arsytet si më poshtë:*

- a) *OE Tibo Communication ShPK nuk disponon rrjetin me fibër optike në aksin e kërkuar Tiranë-Vorë, fakt ky lehtësisht i verifikueshëm në atlasin e vetëdeklarimit të rrjetit në AKEP.*
  - b) *Nëse OE Tibo ka marrë përsipër realizimin e kësaj lidhje brenda afateve të kërkuara në DT duke e rindërtuar rrjetin nga e para kjo është e pamundur nga pikëpamja administrative, ligjore dhe teknike.*
  - c) *Në rast se kërkon që këtë rrjet ta sigurojë nëpërmjet OE të tjerë me kontratë qiraje ky deklaram nuk është i vërtetë. Nga informacionet që disponojmë në cilësinë e operatorit të komunikimeve elektronike rezulton që vetëm dy OE e zotërojnë këtë rrjet dhe të dy këta OE janë ofertues në këtë procedurë dhe nuk kanë ofruar rrjet apo lidhur kontratë për Tibo Communication ShPK. Kërkojmë të mos pranohet deklarata e angazhimit e paraqitur nga OE Tibo Communication ShPK në lidhje me kriterin sa më sipër si dhe skualifikimi i tij nga kjo procedurë.*
- *Në kriteret e veçanta të kualifikimit pika 2.1 kapaciteti profesional i OE ku kërkohet që OE të paraqesin dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së fondit limit të kësaj kontrate.*
- *Nga eksperiencia jonë si OE i madh në treg referuar edhe buletinit të prokurimeve publike kompania Tibo Communication ShPK nuk është pjesëmarrës i rregullt në procedurat e prokurimit publik duke mos pasur besueshmërinë dhe kapacitetet teknike për realizimin e kontratave të kësaj natyre dhe përmase.*
  - *Kontratat faturat e paraqitura nga OE Tibo Communication ShPK nuk mund të konsiderohen si kontrata të ngjashme pasi nuk përmbushin karakteristikat e kontratës në aspektin e kompleksitetit metodologjisë dhe teknologjisë së kërkuar në objektin e prokurimit. Natyra e kontratave të paraqitura nga OE nuk mund të përcaktohet as si e ngjashme dhe aq më pak e njëjtë me objektin e prokurimit. Produktet që kërkohen në objektin e prokurimit janë shërbim interneti dhe intraneti , shërbim dark fibër, dhe shërbim i telefonisë fikse. Ndërkohë që kontratat e ngjashme të paraqitura nga OE janë gjerësisht shërbime interneti kundrejt abonentëve individualë apo biznese në vlera të pakonsiderueshme dhe që kurrësi nuk mund të krijojnë tek KVO bindjen, se ky OE mund të realizojë dhe mirëmbajtje të një kontrate të këtyre përmasave për një periudhë 3 vjeçare. Kërkojmë të verifikohet në mënyrë të detajuar dokumentacioni i paraqitur nga OE në lidhje me kriterin si më sipër (faturat , kontratat) si dhe skualifikimin e tij nga kjo procedurë.*
- *Në kriteret e vecanta të kualifikimit kërkohet: Ofruesi i shërbimit duhet të paraqesë zgjidhjen teknike dhe bllok skemën e plotë për zgjidhjen e ofruar, ku përshkruhen në detaj teknologjitë e përdorura. Për teknologjinë që operatori ekonomik do të përdorë, duhet të paraqesë licencën përkatëse të lëshuar nga AKEP.*

*Albtelecom gjykon se për përmbushjen e këtij kriteri duhet që OE të kenë kapacitete teknike (shtrirjen e rrjetit të tyre fizik) në pothuajse të gjithë territorin e RSH. Nga informacioni i disponuar nga Albtelecom rezulton se OE Tibo Communication ShPK nuk është OE me shtrirje të rrjetit në të gjithë RSH. Për rrjedhojë ky OE nuk duhet të ishte kualifikuar nga AK dhe KVO duke qenë se objekti i procedurës parashikon qartë se shërbimi do të ofrohet në të gjithë institucionet në varësi të OSHEE Group në të gjithë territorin e vendit. Pretendimi më lart është i verifikueshëm fare lehtë edhe nga ekstrakti i regjistrimit të këtij subjekti në QKB. Nga ky dokument vërtetohet se Tibo Communication ShPK nuk ka vende të ushtrimit të aktivitetit as në rajonet kryesore të vendeve ku kërkohet shërbim dhe nuk mund të mundësojë realizimin e kësaj kontrate në shkallën e kërkuar.*

*Sa më sipër në kushtet kur OE ka paraqitur një zgjidhje teknike objektivist të pamundur për tu realizuar prej tij dhe kjo e bën deklaratën e tij për përmbushjen e specifikimeve teknike të pavërtetë, OE Tibo Communication ShPK duhet të skualifikohet nga kjo procedurë.*

- *Në lidhje me ofertën ekonomike tërheqim vëmendjen se oferta e paraqitur nga ky OE është anomalish e ulët. Përlllogaritja e ofertës ekonomike është e pajustificueshme. Oferta e Tibo Communication ShPK nëse do të përlllogaritet për 1 mbps/muaj është 579 lek çmim ky që përfshin kostot, mirëmbajtjen, pajisjet, taksat, tatimet, fitimin etj. Gjithashtu ky çmim përfshin edhe koston e shtrimit të linjës me fibër optike Tiranë-Vlorë prej 172 km. Të gjithë këta elementë e bëjnë anën ekonomike të shërbimeve dhe metodën e ndërtimit të çmimeve të paraqitur nga ky OE të pamundur dhe të pajustificueshme.*

*Ky OE nuk ka minimalisht as reputacionin publik për ofrimin e shërbimeve të kërkuara si internet/intranet/dark fibër dhe telefoni fikse duke qenë se janë të profilizuar në fushën e shërbimeve kryesisht IPTV dhe paketave për familjarë duke mos garantuar shtrirjen gjeografike të kërkuar dhe dhënie të shërbimit në të gjitha pikat ku kërkohet.*

*Sa më sipër kërkojmë skualifikimin e OE Tibo Communication ShPK.*

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.1770/2 prot 23.09.2021 duke referuar kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimues “Albtelecom” SH.A pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik pjesëmarrës në procedurë “Tibo Communication” SHPK.

II.7. Me shkresën nr. 10066/4 prot, datë 01.10.2021 me objekt: “Informacion”, protokolluar me tonën me nr. 1770/14 prot datë 04.10.2021, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga

operatori ekonomik “Albtelecom” SHA për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur mospranimi i ankesës.

II.8. Në datën 29.09.2021 operatori ekonomik i interesuar ka paraqitur pranë KPP shkresën nr. 275 prot datë 08.09.2021 me argumentet si vijon: *Në datën 22.09.2021 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr.1770 e operatorit ekonomik “Albtelecom” SH.A për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr.REF-01153-07-16-2021 me objekt: “Sherbimi i internetit per nje periudhe 3 vjecare”, me fond limit 95,723,816 leke pa TVSh, zhvilluar me datë 23-08-2021 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group Sh. A.*

*Tibo Communication ShPK në cilësinë e subjektit të interesuar në kuptim të nenit 113 të ligjit 162 datë 23.12.2020 dëshirojmë t’ju parashtrojmë se përveç pretendimeve dhe sqarimeve të dorëzuara pranë autoritetit kontraktor pas kërkesës për sqarim të këtij të fundit gjithashtu në zbatim të nenit 84 të LPP-së Tibo Communication deklarojmë se plotësimi i kriterit për xhiron e tre viteve të fundit financiare do të mbështetet në kompaninë Tibo ShPK pasi është pjesë e të njëjtit grup dhe ka të njëjtit ortakë. Bashkëlidhur vërtetimi i xhiros.*

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Albtelecom” SHA mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Tibo Communication” ShPK, me argumentin se *“Në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik Tibo Communication ShPK AK dhe KVO ka gabuar në kualifikimin e operatorit ekonomik Tibo Comunication ShPK pasi ky i fundit nuk përmbush kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT konkretisht: Në kriteret e veçanta të kualifikimit pika 2.2 kapaciteti ekonomik dhe financiar kërkohet: . Vlera e xhiros për të paktën një nga vitet (2018,2019,2020) duhet të jetë jo më e vogël se 100% e vlerës së fondit limit që prokurohet. - Vertetim nga Administrata Tatimore per xhiron e realizuar gjate tre-viteve te fundit (2018,2019,2020) . Operatori ekonomik Tibo Communication ShPK nuk e plotëson kriterin e mësipërm referuar vlerave të xhirove vjetore të këtij operatori ekonomik sipas të dhënave që janë të aksesueshme për të gjithë në QKB. Kërkojmë të verifikohet në mënyrë të detajuar dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik Tibo Communication ShPK në lidhje me kriterin sa më sipër si dhe skualifikimin e tij nga kjo procedurë”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.2 “kapaciteti ekonomik dhe financiar”, përcaktohet kriteri si më poshtë:

*1. Vlera e xhiros për të paktën një nga vitet (2018,2019,2020) duhet të jetë jo më e vogël se 100% e vlerës së fondit limit që prokurohet.*

*Vertetim nga Administrata Tatimore për xhiron e realizuar gjate tre-viteve te fundit (2018,2019,2020) .*

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik Tibo Communication ShPK në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim për xhiron e tre viteve të fundit Nr. T04536534 datë 18.08.2021 lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë, për operatorin ekonomik TIBO Communications ShPK në bazë të të dhënave të situatës financiare të paraqitura për vitet e mëposhtme ka raportuar të ardhura nga shitja e mallrave/shërbimeve si më poshtë:

Viti 2018	XXXXXXX lekë
Viti 2019	XXXXXXX lekë
Viti 2020	XXXXXXX lekë

III.1.3. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

*Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*

III.1.4. Neni 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

- *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe,*

sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

- Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet:
- a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;
- b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;
- c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.
- Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.
- Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.
- Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.
- Në çdo rast, kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

III.1.5. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike në seksionin kërkesat të procedurës së prokurimit objekt ankimi rezulton se autoriteti kontraktor i ka kërkuar kërkesën për sqarim operatorit ekonomik Tibo Communication ShPK me përmbajtje si vijon: Referuar vërtetimit nr. T04536534, date 18.08.2021 leshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tirane, dorezuar ne SPE, Ju lutem ne mbeshtetje te nenit 26, pika 7 dhe nenit 82, pika 2 te VKM 285, date 19.05.2021 te dergoni prane AK sqarimin tuaj ne lidhje me xhiron e tre viteve te fundit financiare.

III.1.6. Lidhur me kërkesën e autoritetit kontraktor sa më sipër operatori ekonomik Tibo Communication ShPK ka sqaruar si vijon: Në përgjigje të kërkesës suaj kriteri parashtruar në VKM nr.285 datë 19.05.2021 neni 43 shoqëria Tibo Communication ShPK e plotëson kriterin ku deri në 31 gusht të 2021 është sa 100% e fondit limit kriter i prokurimit. Shoqëria Tibo Communication është një shoqëri e cila ka ndryshuar pronësi në vitin 2020. Gjatë viteve të fundit financiare 2018-2020 është administruar nga administratorë të tjerë dhe politikat e kompanisë kanë qenë të tjera nga ato çka janë sot. Me ndryshimin e administrimit dhe politikave të shoqërisë Tibo Communication ka arritur që pa u mbyllur ende viti fiskal 2021 të tejkalohet pritshmëritë dhe nivelin e xhiros së kërkuar. Për këtë arsye Tibo Communication



*ShPK merr përsipër t'ju vendosë në dispozicion dokumentacionin e kërkuar nga DPT e cila vërteton informacionin e kërkuar. Ky dokumentacion tërhiqet brenda 10 ditëshit të parë të muajit shtator.*

III.1.7. Ndërkohë, sikundër pasqyruar më sipër rezulton, se në datën 29.09.2021 operatori ekonomik Tibo Communication ShPK, në cilësinë e operatorit ekonomik të interesuar i cili ka rrezik të preket ose cenohet nga ankesa e paraqitur në kuptim të nenit 113 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ka paraqitur pranë KPP-së shkresën nr. 275 prot datë 08.09.2021 me lëndë “informacion” me argumentet si vijon: *Në datën 22.09.2021 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr.1770 e operatorit ekonomik “Albtelecom” SH.A për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr.REF-01153-07-16-2021 me objekt: “Sherbimi i internetit per nje periudhe 3 vjeçare”, me fond limit 95,723,816 leke pa TVSh, zhvilluar me datë 23-08-2021 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group Sh. A.*

*Tibo Communication ShPK në cilësinë e subjektit të interesuar në kuptim të nenit 113 të ligjit 162 datë 23.12.2020 dëshirojmë t'ju parashtrojmë se përveç pretendimeve dhe sqarimeve të dorëzuara pranë autoritetit kontraktor pas kërkesës për sqarim të këtij të fundit gjithashtu në zbatim të nenit 84 të LPP-së Tibo Communication deklarojmë se plotësimi i kriterit për xhiron e tre viteve të fundit financiare do të mbështetet në kompaninë Tibo ShPK pasi është pjesë e të njëjtit grup dhe ka të njëjtit ortakë. Bashkëlidhur vërtetimi i xhiros.*

III.1.8. KPP gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.1.9. Nga shqyrtimi në tërësi i fakteve dhe rrethanave të çështjes objekt shqyrtimi, KPP vëren se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të plotësojnë kushtin për vlerën e xhiros për të paktën një nga vitet

(2018, 2019, 2020), jo më e vogël se 100% e vlerës së fondit limit që prokurohet. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik Tibo Communication ShPK në ditën e hapjes së ofertave në plotësim të këtij kriteri rezulton, se është paraqitur vërtetim nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë me të dhëna financiare, konkretisht për vitin 2018 xhiro vjetore në vlerën XXXXX lekë, për vitin 2019 xhiro vjetore në vlerën XXXXX lekë dhe për vitin 2020 xhiro vjetore në vlerën XXXXX lekë. Ndërkohë fondi limit i procedurës së prokurimit objekt-ankimi është në vlerën 95,723,816 lekë pa TVSh. Në këtë kuptim, KPP gjykon se operatori ekonomik Tibo Communication ShPK me dokumentacionin e paraqitur, vërtetim xhiro për vitet 2018, 2019, 2020, nuk plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit pasi për asnjë nga vitet financiare vlera e xhiros nuk është në masën sa fondi limit i procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Gjithashtu sa i takon sqarimit të dhënë nga operatori ekonomik “Tibo Communication” ShPK në përgjigje të kërkesës së autoritetit kontraktor për plotësimin e kriterit lidhur me xhiron vjetore, e konkretisht argumentet se: *Gjatë viteve të fundit financiare 2018-2020 është administruar nga administratorë të tjerë dhe politikat e kompanisë kanë qenë të tjera nga ato çka janë sot. Me ndryshimin e administrimit dhe politikave të shoqërisë Tibo Communication ka arritur që pa u mbyllur ende viti fiskal 2021 të tejkalojë pritshmëritë dhe nivelin e xhiros së kërkuar. Për këtë arsye Tibo Communication ShPK merr përsipër t’ju vendosë në dispozicion dokumentacionin e kërkuar nga DPT e cila vërteton informacionin e kërkuar. Ky dokumentacion tërhiqet brenda 10 ditëshit të parë të muajit shtator*, KPP gjykon se janë argumente të cilat nuk i shërbejnë plotësimin të kriterit të vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi. KPP gjykon se në momentin e dorëzimit të ofertave operatori ekonomik Tibo Communication ShPK nuk arrin të plotësojë kriterin për xhiro vjetore në një nga vitet financiare në masën sa 100 % të fondit limit. Në këtë kuptim KPP gjykon se rritja e vlerës së xhiros për të ardhmen si pasojë e ndryshimit të politikave dhe administrimit të kompanisë sikundër argumenton operatori ekonomik, është një çështje e brendshme e këtij të fundit dhe mund ti shërbejë atij në rritjen e kapaciteteve për të ardhmen, por në procedurën e prokurimit objekt-ankimi operatori ekonomik Tibo Communication ShPK nuk dëshmon se plotëson kriterin e kualifikimit lidhur me xhiron vjetore në ditën e hapjes dhe vlerësimin të ofertave. Akoma më tej sa i takon shkresës nr. 275 prot datë 08.09.2021 me lëndë “informacion” me argumentet se: *Në datën 22.09.2021 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr.1770 e operatorit ekonomik “Albtelecom” SH.A për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr.REF-01153-07-16-2021 me objekt: “Sherbimi i internetit per nje periudhe 3 vjecare”, me fond limit 95,723,816 leke pa TVSh, zhvilluar me datë 23-08-2021 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group Sh. A. Tibo Communication ShPK në cilësinë e subjektit të interesuar në kuptim të nenit 113 të ligjit 162 datë 23.12.2020 dëshirojmë t’ju parashtrojmë se përveç pretendimeve dhe sqarimeve të dorëzuara pranë autoritetit kontraktor pas kërkesës për sqarim të këtij të fundit gjithashtu në zbatim të nenit 84 të LPP-së Tibo Communication deklarojmë se plotësimi i kriterit për xhiron e tre viteve të fundit financiare do të mbështetet në kompaninë Tibo ShPK, pasi është pjesë e të njëjtit grup dhe ka të njëjtit ortakë. Bashkëlidhur vërtetimi i xhiros, KPP sjell në vëmendje të ankimuesit nenin 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se: **1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të***

**përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta.**

2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t'i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë.

**3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.**

4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit.

5. Nëse operatori ekonomik shfrytëzon aftësi nga subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e marrëveshjes.

6. Ndërkohë, në rastin kur operatorët ekonomikë mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojë oferta ose të paraqitet si një kandidat i vetëm. 7. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që detyra/punë/aspekte kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjëri prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ofertues.

III.1.10. Në rastin konkret, KPP nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik Tibo Communication ShPK në sistemin e prokurimeve elektronike konstaton, se ky i fundit nuk ka dorëzuar në ditën e hapjes së ofertave asnjë angazhim me shkrim mes subjekteve që dëshirojnë të mbështeten në kapacitete në kuptim të dispozitës ligjore sa më sipër. Në interpretim të nenit 84 të LPP-së, angazhimi i subjekteve duhet të kryhet **me shkrim**, në mënyrë që të bëhet e njohur për autoritetin kontraktor në momentin e vlerësimit të ofertave. Për më tepër KPP gjykon, se operatori ekonomik Tibo Communication ShPK ka dhënë argumente konfuzë dhe të paqarta, pasi në momentin e kërkesës për sqarim nga autoriteti kontraktor sikundër analizuar më sipër, ka pretenduar se përmbush kriterin lidhur me vlerën e xhiros vjetore, pasi në vitin 2021 është rritur performanca e këtij subjekti, si pasojë e ndryshimit të politikave dhe administrimit. Ndërkohë në momentin e paraqitjes së argumenteve në cilësinë e subjektit të interesuar pretendon, se plotësimi i kriterit për xhiron e tre viteve të fundit financiare do të mbështetet në kompaninë Tibo ShPK, pasi është pjesë e të njëjtit grup dhe ka të njëjtët ortakë. KPP gjykon, se në të dyja rastet, si tek argumenti i parë i dhënë nga operatori ekonomik Tibo Communication ShPK për rritjen e performancës për vitin 2021 dhe tek argumenti i dytë për mbështetjen në kapacitete tek operatori Tibo ShPK si pjesë e të njëjtit grup, nuk mund të konsiderohen të vlefshme dhe bindëse në funksion të plotësimin të kriterit kualifikues. Kjo për shkak se rritja e performancës për vitin 2021 sikundër arsyetuar edhe më sipër, mund të shërbejë operatorit në procedurat pasardhëse,

por nuk mund të shërbejë për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, sa kohë që periudha financiare e kërkuar në kriterin e veçantë të kualifikimit është tre vitet e fundit 2018, 2019, 2020. Ndërkohë argumenti i dytë për mbështetjen në kapacitete nuk është bërë në formën e kërkuar ligjore dhe në momentin e duhur procedural, pasi në dokumentet e dorëzuara në SPE nuk rezulton të jetë hedhur asnjë deklaratë angazhimi me shkrim mes subjekteve për mbështetjen në kapacitete.

Sa më sipër KPP gjykon, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriteve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Tibo Communication” ShPK nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Albtelecom” SHA qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Albtelecom” SHA mbi kualifikimin e shoqërisë “Tibo Communication” ShPK., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk do të merren në shqyrtim, pasi referuar gjykimit më sipër gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Tibo Communication” ShPK do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht duke përmbushur interesin e ankimuesit.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Albtelecom” SHA për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr.REF-01153-

07-16-2021 me objekt: “Shërbimi i internetit për një periudhë 3 vjeçare”, me fond limit 95,723,816 leke pa TVSh, zhvilluar me datë 23-08-2021 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group Sh.A.

2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Tibo Communication” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë “Albtelecom” SHA.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaïd Myzyri**